




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA E KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
KUVENDI KOMUNAL / ASSEMBLY OF MUNICIPALITY / SHURSHI KUDRETI NE SKENDERAJ	
Nr.	
No.	02-060/01-0000/118/24
Data.	
Data.	03.01.2024



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika/Office of the Mayor

PROCESVARBALI I TAKIMIT TË KRYETARIT TË KOMUNËS, FADIL NURA, ME QYTETARË TË SKENDERAJT (i dyti për vitin aktual), I MBAJTUR MË 22 DHJETOR 2023 NË SALLËN E KUVENDIT KOMUNAL

Të pranishëm në takim: Kryetari Nura, drejtori për Buxhet dhe Financa Ismet Aliu, drejtori për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit Driton Mulaj dhe drejtoresha për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër Blerta Dobra-Geci.

Të pranishëm 20 qytetarë (11 F – 9 M; mosha: 25 – 65 vjeç)

Kryetari Nura: Përshëndetje të gjithëve!

Po mbajmë sot këtë takim, i dyti për këtë vit, në kuadër të përmbushjes së obligimit ligjor, që parashihen dy takime brenda vitit, takime me qytetarë, për t'i informuar për punët në komunën e Skenderajt.

Sic e dini, në fillim të këtij viti, kishim sfida të mëdha, vërshimet e 19 janarit, të cilat kanë shkaktuar probleme të mëdha në infrastrukturën publike, rrugë, ekonomi familjare, bujqësi dhe në fusha tjera. Megjithatë ne si qeveri jemi përpjekur vazhdimisht për të punuar në të mirë të qytetarëve, nëpërmjet projekteve kapitale. Në 6 mujorin e dytë të këtij viti, kemi subqendrën në Runik që kemi filluar të realizojmë, është premtim i qeverisjes sonë. Sa u përket dy subqendrave tjera në Qirez dhe Likoc, ne kemi përfunduar të gjitha procedurat që na takojnë, ndërkaq në OSHP janë disa ankesa nga operatorët ekonomik, që kanë zvarrit

lidhjen e kontratave dhe fillimin e punimeve. Megjithatë, besojmë vitin e ardhshëm të nisim edhe këty do projekte.

Kemi realizuar një numër të madh të projekteve, të cilat disa kanë përfunduar e disa janë duke vazhduar, ato me kontrata në vazhdim. Sic e thash, fillimviti ka qenë i vështirë, vërshimet na kanë detyruar të bëjmë disa ndryshime në planifikim të projekteve. Jemi fokusuar pas këtyre vërshimeve të trajtojmë me prioritet Lumin Klina dhe lumenjtë tjerë, në mënyrë që të ulim rrezikun e përmbytjeve dhe dëmëve që mund të shkaktohen. Për dëmet që janë shkaktuar, nuk kemi pas përkrahje deri më tani nga niveli qendror, përveç kompensimit të ekonomive familjare që janë dëmtuar, kurse në dëmet në infrastrukturën publike, nuk jemi mbështetur. Disa nga projektet kapitale janë unazat rrugore, ajo e brendshmeja dhe e jashtmeja që lidh qytetin me fshatin Llaushë. Kemi realizuar projektin e Sahat Kullës, kemi nënshkruar kontratën për ndërtimin e stacionit të autobusëve, kemi përfunduar projektin e poligonit multifunksional, zgjerimi i bulevardit Ilaz Kodra, dhe një numër i madh i projekteve tjera në dobi të qytetarëve. Vlerësojmë se krahas mundësive që kemi pas dhe problemeve, kemi realizuar një numër të të projekteve në të gjitha fushat e përgjegjësisë sonë. Është kjo një përmbledhje e punëve gjatë kësaj periudhe, jam i gatshëm të përgjigjem në cdo pyetje apo çështje që ju ngritni. Prandaj, fjala është për ju.

Murat Mehmeti: Jemi dëshmitarë të sfidave sic ishin vërshimet. Një pyetje e kam për projektin kapital të ujësjellësit në Likoc me 12 fshatra tjera. Deri ku kanë shkuar procedurat dhe a është gati të finalizohet ky projekt? Edhe për fshatin Burojë, desha me ditë a pritët të përfundojë edhe ky projekt?

Kryetari Nura: E kemi në buxhet për vitin e ardhshëm punët për projektin e ujësjellësit në Likoc. Na ka munguar vetëm kyçja e trafos elektrike, për të funksionalizuar këtë projekt. Sa i përket projektit për Burojë, është formuar komisioni për pranim teknik të projektit, pra është në fazën e pranimit teknik. Për ujë, sa herë që të ketë për qytet, do të ketë edhe për ato fshatra ku është i shtrirë sistemi dhe janë përfunduar kyçjet individuale. Megjithatë kemi mungesë të ujit. Edhe në Qirez jemi duke realizuar projektin e shtrirjes së gypit kryesor.

Zymer Hasani: Në Burojë kur do të përurohet projekti i ujësjellësit?

Drejtori Mulaj: Kanë përfunduar punimet për kycjet e 90 shtëpive. Testimet janë bërë para 2 jave. Ka pas telashe në lagjen Duraku. Por do të kryhet edhe ky projekt në janar. Gypi kryesor është i shtrirë në të gjithë fshatin. Ka disa shtëpi që nuk janë kyçur, por edhe ato do të përfundohen.

Dardan Thaci: Në Burojë një rrugicë te shtëpia e Sejdi Thacit, ka mbetur pa u trajtuar, të futet në projektin për vitin e ardhshëm.

Drejtori Mulaj: Besojmë vitin e ardhshëm do të shtrojmë edhe këtë rrugicë me asfalt.

Kryetari Nura: Nëse nuk ka dikush tjetër ndonjë çështje për diskutim, apo pyetje, e deklaroj të përfunduar këtë takim. Faleminderit për pjesëmarrje dhe mirë u pafshim!

Procesmbajtësi:

Jeton Rushiti

